



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr. 239/2020  
Datë: 26 tetor 2020

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.12, 1.17 dhe 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen 240, të mbajtur me datë 26 tetor 2020, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet kërkesa e Departamentit të Administratës së Përgjithshme në SKGJK, për dhënien e autorizimit për shpalljen e pozitave të lira dhe përgatitjen e planit të përgjithshëm të personelit.
- II. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për iniciimin e procedurave të rekrutimit për plotësimin e pozitave të cilat janë të lira në administratën e gjyqësorit sipas Ligjit nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 (i plotësuar dhe ndryshuar).
- III. Ky vendim hyn në fuqi më datë 26 tetor 2020

Skender ÇOÇAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.